

Elterninformation Albanisch

(aus dem Leitfaden für Schulleitungen zum Thema Blackout, Version 1.2. Beilage zum Rundschreiben Nr. 29/2022, Denkleitfaden zur Blackoutvorsorge für Schulleitungen (2022-0.753.776))

Shumë të nderuar prindër dhe persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte)!

Në njërën prej takimeve tona me prindër kemi folur tashmë me ju për mundësinë e ndërprerjes së energjisë elektrike dhe përgatitjet e bëra në lidhje me këtë. Për shkak të rrethanave konkrete, po i japim tani fëmijës suaj këtë letër, e cila përmban informacione të rëndësishme për ju dhe familjen tuaj mbi mënyrën se si duhet të veproni gjatë vazhdimit të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Ne të gjithë ndodhemi në një situatë të vështirë, prandaj ju lutemi ta ndihmoni fëmijën tuaj. Ruani qetësinë dhe qetësoni edhe fëmijën tuaj. Kjo prerje e dritave do të kalojë përsëri. Sa kohë që nuk ka drita, qëndroni sa të keni mundësi me fëmijën tuaj në shtëpi dhe dëgjoni rregullisht radion. Ö3 dhe stacionet rajonale do t'ju informojnë për situatën. Gjatë këtyre ditëve, deri sa shkolla të hapet përsëri, sigurisht që automatikisht nuk ka mësim.

Sapo të ketë përsëri energji elektrike dhe shkollat e transporti publik etj. të rifillojnë punën, ne do t'ju dërgojmë padyshim informacione të tjera mbi funksionimin e shkollave. Ju lutemi që ta dërgoni fëmijën tuaj përsëri në shkollë vetëm pasi të keni marrë vesh prej nesh ose nga radioja se çfarë do të bëhet më tej për rifillimin e shkollës.

Deri atëhere bëni durim, gjithë të mirat!

Drejtoria e shkollës suaj

Ndërprerja e energjisë elektrike - Informacion për prindërit (personat me të drejtë kujdestarie)

Në rast të një blackout-i (= një ndërprerje e gjatë dhe në të gjithë vendin e energjisë elektrike) në çast nuk funksionojnë më pothuajse të gjitha sistemet elektrike, të infrastrukturës dhe ato të furnizimit, nuk mund ta telefonosh dikë ose të shkruash një mesazh, nuk mund të blesh, të përdorësh mjetet e transportit publik që furnizohen me energji elektrike, të përdorësh interfonin/zilen/ashensorin etj.

Mund të zgjasë disa ditë derisa e gjithë infrastruktura të vihet përsëri në funksionim, edhe nëse furnizimi me rrymë funksionon përsëri. Vetëm stacioni Ö3 i ORF-it (ose stacione rajonale) mund të transmetojnë lajme të rëndësishme.

1. Nxënësit dhe nxënëset e CIKLIT TË LARTË (OBERSTUFE), në bazë të planit të organizimit të lëshimit (shih shtojcën), lirohen sa më shpejt dhe shkojnë në shtëpi.
2. Në rast se në kampusin shkollor është edhe një vëlla a motër tjetër, vëllezërit dhe motrat më të mëdha i marrin më të vegjlit nga institucioni arsimor përkatës dhe shkojnë së bashku në shtëpi.
3. Prindërit (personat me të drejtë kujdestarie) të nxënësve e nxënësve të CIKLIT TË ULËT (UNTERSTUFE) janë të lutur të plotësojnë formularin e mëposhtëm dhe t'ia japin këtë mësuesit a mësueses kujdestare të klasës sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ato shtypen, ruhen në një vend qendror dhe përdoren në rast nevojë.

[opsion për nxënësit e nxënëset që banojnë në internat]

1. Nxënësit e nxënëset e CIKLIT TË LARTË , familjarët e afërm të të cilëve banojnë në afërsi të shkollës, dërgohen sa më shpejt që të jetë e mundur në shtëpi sipas planit të organizimit të lëshimit (shih shtojcën).
2. Prindërit e nxënësve e nxënësve të CIKLIT TË ULËT, familjarët e afërm të të cilëve banojnë në afërsi të shkollës, plotësojnë gjithashtu formularin dhe fëmijët e tyre dërgohen gjithashtu në shtëpi sipas kriterëve të përcaktuara.
3. Nxënësit e nxënëset e CIKLIT TË ULËT dhe TË LARTË, familjarët e afërm të të cilëve nuk banojnë afër shkollës (janë jashtë shtetit, në një land tjetër) dhe nuk kanë ende në zotërim një mjet transporti personal
 - a. qëndrojnë në internat derisa t'i marrin
 - b. lejohen të shkojnë bashkë me fëmijë të tjerë, me të cilët kanë miqësi dhe të cilët banojnë afër shkollës

Ju lutemi të plotësoni gjithashtu shtojcën.

Elterninformation Albanisch

(aus dem Leitfaden für Schulleitungen zum Thema Blackout, Version 1.2. Beilage zum Rundschreiben
Nr. 29/2022, Denkleitfaden zur Blackoutvorsorge für Schulleitungen (2022-0.753.776)

Ne rekomandojmë që gjatë ndërprerjes së energjisë elektrike të qëndroni sa më shumë që të jetë e mundur në shtëpi dhe (në çdo orë fiks) të dëgjoni radion, të ndihmoni fqinjët, të kurseni ujin e ushqimet, si dhe të mbyllni me kujdes qeset ose kazanët e plehrave për të mënjanuar ndonjë epidemi të mundshme.

Elterninformation Albanisch

(aus dem Leitfaden für Schulleitungen zum Thema Blackout, Version 1.2. Beilage zum Rundschreiben
Nr. 29/2022, Denkleitfaden zur Blackoutvorsorge für Schulleitungen (2022-0.753.776))

BEILAGE Blackout – Entlassungsmanagement SHTOJCË Blackout – Organizimi i lëshimit

Zuname/Mbiemri: _____ Vorname/Emri: _____

Klasse/Klasa: _____

Geschwisterkind(er) am Campus /Vëlla ose motër në kampus: o Ja/Po o nein/jo

Wenn ja wo/Nëse po, ku? _____

(Lebensmittel-) Allergien/Alergji nga ushqimet:

Mein Kind darf wird im Falles eines Blackouts/Fëmija im në rast të një ndërprerjeje të energjisë elektrike ... (bitte Zutreffendes ankreuzen/vendosni një kryq në pikën e përshtatshme për ju)

- alleine nachhause gehen/lejohe të shkojë vetë në shtëpi.
- mit seinen Geschwistern/me vëllezërit e motrat e tij – ohne Begleitung eines/r Erwachsenen/pa u shoqëruar nga një i rritur ose e rritur – nachhause gehen/lejohe të shkojë në shtëpi.
- von einem/r Erziehungsberechtigten zeitnah abgeholt/do të merret brenda një kohe të shkurtër nga një person me të drejtë kujdestarie.
- im Internat bleiben/do të qëndrojë në internat.
- mit folgendem/r Schüler:in bzw. folgender Familie mitgehen/do të shkojë së bashku me nxënësin a nxënësen ose familjen e mëposhtme :

_____ Klasse/Klasa: _____

Ich habe die Informationen, wie im Falle eines Blackouts im [Schulname] gehandelt wird, gelesen und zur Kenntnis genommen/Unë i kam lexuar dhe pranuar informacionet lidhur me mënyrën se si do të veprohet në [emri i shkollës] në rast të një ndërprerjeje të energjisë elektrike.

Datum Unterschrift eines/r Erziehungsberechtigten Data Nënshkrimi i personit me të drejtë kujdestarie